



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Raport mbi zbatimin e
Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të
dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikë së Kosovës -
Agjendës për Reforma Evropiane (PV ERA II)
gjatë periudhës korrik - shtator 2021

Janar 2022
Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	3
0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PV ERA II GJATË PERIUDHËS KORRIK – SHTATOR 2021	4
0.1. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla I – Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit	5
0.2. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla II – Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm	7
0.3. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla III – Punësimi, arsimi dhe shëndetësia	9
0.4. Gjendja sipas institucioneve	10
1. SHTYLLA I: QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT	12
1.1. Prioriteti 1.1. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjyqësori dhe punët e brendshme	12
1.2. Prioriteti 1.2. Reforma e administratës publike	16
1.3. Prioriteti 1.3. Të drejtat dhe liritë themelore	18
1.4. Prioriteti 1.4. Reforma zgjedhore	20
2. SHTYLLA II: KONKURRUESHMËRIA, KLIMA E INVESTIMEVE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	22
2.1. Prioriteti 2.1. Tregu i brendshëm, investimet, sektori privat dhe NMVM-të	22
2.2. Prioriteti 2.2. Energjia	23
2.3. Prioriteti 2.3. Mjedisi	25
2.4. Prioriteti 2.4. Menaxhimi i financave publike dhe prokurimi publik	26
2.5. Prioriteti 2.5. Konkurrenca dhe ndihma shtetërore	28
2.6. Prioriteti 2.6. Trajtimi i ekonomisë joformale	28
3. SHTYLLA III: PUNËSIMI, ARSIMI DHE SHËNDETËSIA	29
3.1. Prioriteti 3.1. Rimëkëmbja sociale dhe ekonomike pas COVID-19	29
3.2. Prioriteti 3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	29
3.3. Prioriteti 3.3. Shëndeti dhe siguria në punë	30
3.4. Prioriteti 3.4. Arsimi	32
3.5. Prioriteti 3.5. Shëndetësia	33

HYRJE

Faza e dytë e prioriteteve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës – Agjenda për Reforma Evropiane (ERA II) – është dokument i përbashkët për përbushjen e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), përkatësisht për zbatimin e reformave prioritare që kërkojnë vëmendjen e nivelit më të lartë politik. ERA II, me 15 prioritete, është vazhdimësi e fazës së parë të (22) prioriteteve politike, të dakorduara në vitin 2016. Këto prioritete fokusohen në reformat kyçe ekonomike, për forcimin e sundimit të ligjit dhe të qeverisjes demokratike, si dhe për zbatimin e reformave strukturore në fushat e arsimit, punësimit dhe shëndetësisë. Për zbatimin e këtyre prioriteteve, institucionet e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, kanë hartuar Planin e Veprimit (PV ERA II), i cili është miratuar nga Qeveria, më 11 gusht 2021, dhe nga Kuvendi, më 4 tetor 2021. Prioritetet e ERA II, përmes këtij plani veprimi, do të zbatohen brenda një periudhe dyvjeçare, deri në mesin e vitit 2023.

PV ERA II përmban 15 prioritete dhe 341 reforma specifike (të formuluar si tregues), të shpërndarë si në vijim:

- Shtylla I: *Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit*, e cila përmban 4 prioritete dhe 153 tregues;
- Shtylla II: *Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm*, e cila përmban 6 prioritete dhe 121 tregues; dhe
- Shtylla III: *Punësimi, arsimit dhe shëndetësia*, e cila përmban 5 prioritete dhe 67 tregues.

Qeveria, si institucioni qendror kombëtar i ngarkuar me çështjen e integritimit evropian, dhe rrjedhimisht përbushjen e detyrimeve të dala nga MSA-ja, është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e PV ERA II, në bashkëpunim me Kuvendin, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera të pavarura. Në kuadër të Qeverisë, ky proces koordinohet nga ana e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) si institucioni kryesor koordinues përgjegjës për integrim evropian – përmes Zëvendëskryeministrit të Parë për Integrim Evropian, Dialog dhe Zhvillim, si i emëruar politik i nivelit më të lartë përgjegjës për këtë proces, si dhe departamenteve për integrim evropian (ZKM/DIE). Zbatimi dhe monitorimi i PV ERA II gjithashtu drejtohet dhe mbikëqyret përmes kabinetit të Qeverisë dhe përmes strukturave koordinuese ndërinsticionale për integrim evropian.

Zbatimi i PV ERA II gjithashtu trajtohet përmes organeve të përbashkëta të stabilizim-asociimit BE-Kosovë të krijuara përmes MSA-së si dhe mekanizmave të tjerë të integritimit në BE. Organizatat e shoqërisë civile, shoqatat afariste dhe palët e tjera të interesit gjithashtu përfshihen në monitorimin e zbatimit të tij përmes konsultimeve të rregullta. E fundit por jo për nga rëndësia, media dhe publiku i gjerë informohen mbi përparimet dhe gjendjen në zbatimin e ERA II përmes raporteve të rregullta.

Raportet e rregullta mbi zbatimin e PV ERA II hartohen dhe publikohen nga ZKM-së çdo tre muaj. Ky është *raporti i parë*, i cili mbulon periudhën *deri në fund të shtatorit 2021*. Ai përmbledh zhvillimet gjatë periudhës raportuese dhe gjendjen në fund të periudhës raportuese. Raporti është hartuar nga ZKM, bazuar në të dhënat e raportuara nga të gjitha institucionet zbatuese.

Ky raport përmban katër kapituj që japin një përmbledhje në formë narrative dhe grafike, mbi përparimet dhe gjendjen e zbatimit gjatë periudhës raportuese. Kapitulli 0 fokusohet në PV ERA II në tërësi, sipas shtyllave dhe sipas institucioneve përgjegjëse, ndërsa tre kapitujt e tjerë në gjendjen e zbatimit të shtyllave përkatëse: kapitulli 1 të shtyllës së parë, kapitulli 2 të shtyllës së dytë dhe kapitulli 3 të shtyllës së tretë. Secili kapitull përmbledh gjendjen në nivel të prioriteteve dhe treguesve.


Gjetjet tregojnë se *deri në fund të shtatorit 2021 të gjithë prioritetet kanë qenë në zbatim e sipër*. Në anën tjetër, sa u përket treguesve, niveli i zbatimit është **39.02%** pasi që **16 nga 41 tregues** të planifikuar për t'u zbatuar gjatë kësaj periudhe janë zbatuar, ndërsa 25 (60.98%) prej tyre kanë qenë në zbatim e sipër.

0. PASQYRË MBI ZBATIMIN E PV ERA II GJATË PERIUDHËS KORRIK – SHTATOR 2021

Plani i Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës – Agjendës për Reforma Evropiane (PV ERA II) përmban 15 prioritete dhe 341 tregues.

Sa i përket ecurisë së zbatimit të prioriteteve deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjitha prioritetet kanë filluar së zbatuari dhe janë në zbatim e sipër.

Diagrami 0.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të treguesve të PV ERA II deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 10.56% e treguesve, 36 tregues, janë zbatuar;
- 48.97% e treguesve, 167 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 10.85% e treguesve, 37 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 11.44% e treguesve, 39 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 18.18% e treguesve, 62 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e PV ERA II, 41 (12%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2021 (6 gjatë tremujorit të dytë dhe 35 gjatë tremujorit të tretë).

Diagrami 0.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 39.02% e treguesve, 16 tregues, janë zbatuar;
- 60.98% e treguesve, 25 tregues, përballen me vonesa serioze.

0.1. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla I – Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

Kjo shtyllë përmban 4 prioritetet dhe 153 tregues.

Sa i përket ecurisë së zbatimit të prioriteteve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjitha prioritetet kanë filluar së zbatuari dhe janë në zbatim e sipër.

Diagrami 0.1.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla I – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të treguesve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 15.69% e treguesve, 24 tregues, janë zbatuar;
- 49.02% e treguesve, 75 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 6.54% e treguesve, 10 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 13.72% e treguesve, 21 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 15.03% e treguesve, 23 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e kësaj shtylle, 24 (15%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë periudhës prill – shtator 2021 (3 gjatë tremujorit të dytë dhe 21 gjatë tremujorit të tretë).

Diagrami 0.1.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla I – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës prill – shtator 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 41.67% e treguesve, 10 tregues, janë zbatuar;
- 58.33% e treguesve, 14 tregues, përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, treguesit e kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese të cilët nuk kanë arritur të zbatohen gjatë afatit të paraparë janë si në vijim:

- Prioriteti 1.1. *Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme:*
 - Miratimi i Kodit të Procedurës Penale;
 - Miratimi i projektligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
 - Miratimi i projektligjit për deklarin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publik;
 - Miratimi i UA për Ekipet e Përbashkëta të Hetimit;

- *Miratimi i UA dhe PSO për trajtimin e informatorëve, të hartuara dhe miratuara*
- *Miratimi i Strategjisë për Migrim 2020-2025;*
- *Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimi ndërinstytucional në fushën e migracionit përmes AQM-së;*
- *Miratimi i planit strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.*
- **Prioriteti 1.2. Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, bazuar në kornizën e re ligjore në fuqi:**
 - *Miratimi i udhëzuesit për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive për zbatimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura;*
 - *Miratimi i udhëzuesit për zhvillimin e intervistës;*
 - *Hartimi i memorandumit shpjegues rreth projektligjit për valën e dytë të racionalizimit të agjencive.*
- **Prioriteti 1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore:**
 - *Rishikimi i projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media;*
 - *Miratimi i programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;*
- **Prioriteti 1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore:**
 - *Themelimi i Komitetit ad hoc dhe Grupit Këshillëdhënës.*

Në anën tjetër, treguesit e kësaj shtylle që përballen me sfida dhe vonesa të mundshme dhe që kërkojnë vëmendje janë si në vijim:

- **Prioriteti 1.1. Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme:**
 - *Miratimi i koncept dokumentit për krijimin e fondit të konfiskimit;*
 - *Themelimi i strukturave për koordinimin dhe monitorimit të strategjisë sektoriale të sundimit të ligjit;*
 - *Miratimi i planit strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.*
- **Prioriteti 1.2. Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, bazuar në kornizën e re ligjore në fuqi:**
 - *Miratimi i Ligjit për paga;*
 - *Miratimi i Ligjit për zyrtarë publikë;*
 - *Miratimi i gjashtë (6) rregulloreve për zbatimin e ligjit për zyrtarët publikë;*
- **Prioriteti 1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore:**
 - *Miratimi i koncept dokumentit për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve;*
- **Prioriteti 1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore:**
 - *Kryerja e auditimeve të rregullta të partive politike në kohë;*
 - *Numri i raporteve financiare të subjekteve që pas auditimit që marrin opinionin 'mohim i opinionit'.*

0.2. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla II – Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Kjo shtyllë përmban 6 prioritetet dhe 121 tregues.

Sa i përket ecurisë së zbatimit të prioritetëve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjitha prioritetet kanë filluar së zbatuari dhe janë në zbatim e sipër.

Diagrami 0.2.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla II – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të treguesve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 7.44% e treguesve, 9 tregues, janë zbatuar;
- 47.11% e treguesve, 57 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 11.57% e treguesve, 14 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 8.26% e treguesve, 10 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 25.62% e treguesve, 31 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e kësaj shtylle, 10 (8.26%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë periudhës nga prilli deri në shtator të vitit 2021 (1 gjatë tremujorit të dytë dhe 9 gjatë tremujorit të tretë).

Diagrami 0.2.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla III – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e treguesve, 4 tregues, janë zbatuar;
- 60% e treguesve, 6 tregues, përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, treguesit e kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese të cilët nuk kanë arritur të zbatohen gjatë afatit të paraparë janë si në vijim:

- Prioriteti 2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të: ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- Prioriteti 2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të efijencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme:
 - Miratimi i UA për kornizën e përgjithshme të raportimit për efijencën e energjisë;

- *Miratimi i UA për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MZhE) nr. 03/2019 mbi përmbajtjen e energjisë së karburanteve të zgjedhura për përdorim përfundimtar;*
- *Miratimi i Koncept Dokumentit për BRE.*
- **Prioriteti 2.3. Trajtimi i sfidave prioritare mjedisore:**
 - *Miratimi i projektligjit për mbeturinat;*
 - *Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;*
 - *Fillimi i zbatimit të projekteve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme: objektin për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme, dekomisionimi i TC Kosova A.*
- **Prioriteti 2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i zbatimit të menaxhimit të financave publike dhe reformave të prokurimit publik:** ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- **Prioriteti 2.5. Fuqizimi i mëtejshëm i institucioneve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore:** ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- **Prioriteti 2.6. Vazhdimi i përpjekjeve për të trajtuar ekonominë joformale:** ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.

Në anën tjetër, treguesit e kësaj shtylle që përballen me sfida dhe vonesa të mundshme dhe që kërkojnë vëmendje janë si në vijim:


- **Prioriteti 2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të:**
 - *Zbatimi i Sistemeve të menaxhimit të cilësisë sipas EN ISO/17025 dhe fillimi i zbatimit të standardit EN ISO / IEC 17020 siç është e rëndësishme për Infrastrukturën e Cilësisë;*
 - *Përditësimi i Regjistrat qendror të lejeve dhe licencave në mënyrë që sistemi të jetë i përdorshëm për zyrtarët që kanë qasje në të dhëna dhe trajnimi i 52 zyrtarëve nga ZL dhe institucioneve që lëshojnë leje dhe licenca mbi përdorimin e sistemit të përditësuar.*
- **Prioriteti 2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme:**
 - *Miratimi i UA për shërbimet e energjisë (ESCO) për sektorin privat dhe atë të ekonomive familjare.*
- **Prioriteti 2.3. Trajtimi i sfidave prioritare mjedisore:**
 - *Fillimi i hartimit të strategjisë për dekarbonizim;*
 - *Trajnimi i inspektorëve për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave;*
 - *Trajnimi i inspektorëve për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore si dhe burimeve ujore.*
- **Prioriteti 2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i zbatimit të menaxhimit të financave publike dhe reformave të prokurimit publik:**
 - *Miratimi i Strategjisë së re për RMFP 2022-2026;*
 - *Miratimi i planit të veprimit 2022 të Strategjisë për RMFP;*
 - *Miratimi i koncept dokumentit për themelimin e një trupi fiskal të pavarur i miratuar pas konsultimit me palët e interesit përfshirë edhe BE-në.*
- **Prioriteti 2.5. Fuqizimi i mëtejshëm i institucioneve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore:**
 - *Miratimi i planit të veprimit të AKK-së për vitin 2022.*
- **Prioriteti 2.6. Vazhdimi i përpjekjeve për të trajtuar ekonominë joformale:** ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.

0.3. Gjendja sipas shtyllave: Shtylla III – Punësimi, arsimi dhe shëndetësia

Kjo shtyllë përmban 5 prioritetet dhe 67 tregues.

Sa i përket ecurisë së zbatimit të prioriteteve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjitha prioritetet janë në zbatim e sipër

Diagrami 0.3.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla III – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të treguesve të kësaj shtylle deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 4.48% e treguesve, 3 tregues, janë zbatuar;
- 52.24% e treguesve, 35 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 19.40% e treguesve, 13 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 11.94% e treguesve, 8 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 11.94% e treguesve, 8 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjitha treguesit e kësaj shtylle, 7 tregues (10.44%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë periudhës prill – shtator 2021 (2 gjatë tremujorit të dytë dhe 5 gjatë tremujorit të tretë).

Diagrami 0.3.2. Zbatimi i PV ERA III gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Shtylla III – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 28% e treguesve, 2 tregues, janë zbatuar;
- 72% e treguesve, 5 tregues, përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, treguesit e kësaj shtylle të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese të cilët nuk kanë arritur të zbatohen gjatë afatit të paraparë janë si në vijim:

- Prioriteti 3.1. Zbatimi i masave me objektiva të qartë për rimëkëmbje sociale dhe ekonomike pas COVID-19: ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- Prioriteti 3.2. Përmirësimi i punësimit dhe mirëqenies së përgjithshme:
 - Krijimi i një grupi ekspertësh dhe një Grupi të Nivelit të Lartë për Skemën e garantimit për të rinj.
- Prioriteti 3.3. Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë: ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.

- Prioriteti 3.4. *Përmirësimi i sistemit arsimor të Kosovës:*
 - *Miratimi i projektligjit për Agjencinë e Akreditimit;*
 - *Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MASHTI;*
 - *Miratimi i standardeve për monitorim.*
- Prioriteti 3.5. *Forcimi i funksioneve kryesore të sistemit shëndetësor:* ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.


Në anën tjetër, treguesit e kësaj shtylle që përballen me *sfida dhe vonesa të mundshme* dhe që *kërkojnë vëmendje* janë si në vijim:

- Prioriteti 3.1. *Zbatimi i masave me objektiva të qartë për rimëkëmbje sociale dhe ekonomike pas COVID-19:* ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- Prioriteti 3.2. *Përmirësimi i punësimit dhe mirëqenies së përgjithshme:* ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- Prioriteti 3.3. *Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë:* ky prioritet nuk përmban ndonjë tregues të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese.
- Prioriteti 3.4. *Përmirësimi i sistemit arsimor të Kosovës:*
 - *Miratimi i projektligjit për arsimin e lartë;*
 - *Miratimi i Planit Strategjik i AKA-s;*
 - *Rekrutimi i 25 inspektorëve të rinj të arsimit, përmes procesit konkurrues;*
 - *Realizimi i vlerësimit dhe përfshirja e rekomandimeve në PSAK të ri.*
- Prioriteti 3.5. *Forcimi i funksioneve kryesore të sistemit shëndetësor:*
 - *Miratimi i Projektligjit për sigurime shëndetësore;*
 - *Miratimi i Strategjisë sektoriale të shëndetësisë 2022-2032;*
 - *Miratimi i planit të veprimit për adresimin e rekomandimit (ECDC) të vlerësimit të Kosovës për zhvillimin e kapaciteteve, qeverisjen shëndetësore, mbikëqyrjen, gatishmërinë dhe përgjigjen në fushën e sëmundjeve të transmetueshme;*
 - *Kryerja e Studimit të fizibilitetit për SISH.*

0.4. Gjendja sipas institucioneve

Kjo pjesë jep një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të PV ERA II për institucionet të cilat kanë planifikuar zbatim të treguesve gjatë periudhës prill – shtator 2021. Me qëllim të vlerësimit të performancës, institucionet janë radhitur sipas përqindjes së treguesve të zbatuar, nga ai me performancën më të dobët deri te ai me performancën më të mirë.

Diagrami 0.4.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës prill – shtator 2021: performanca e institucioneve të Qeverisë




Sa i përket performancës së institucioneve të Qeverisë në zbatimin e treguesve nën përgjegjësinë e tyre të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës prill – shtator 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – 0% (0 / 3 tregues të zbatuar);

- Zyra e Kryeministrit (ZKM) – 25% (1 / 4 tregues të zbatuar);
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – 25% (1 / 4 tregues të zbatuar);
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – 33% (1 / 3 tregues të zbatuar);
- Ministria e Ekonomisë (ME) – 40% (2 / 5 tregues të zbatuar);
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) – 41.67% (5 / 12 tregues të zbatuar);
- Ministria e Drejtësisë (MD) – 25% (1 / 4 tregues të zbatuar);
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) – 100% (1 / 1 tregues të zbatuar);
- Ministria e Shëndetësisë (MSh) – 100% (1 / 1 tregues të zbatuar).

Performanca e institucioneve tjera të Qeverisë gjatë periudhës prill – shtator 2021 nuk mund të matet, pasi që asnjë tregues nën përgjegjësinë e tyre nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë kësaj periudhe.

Diagrami 0.4.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës prill – shtator 2021: performanca e institucioneve të pavarura



Në anën tjetër, sa i përket performancës së institucioneve të pavarura në zbatimin e treguesve nën përgjegjësinë e tyre të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës prill – shtator 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës (Kuvendi) – 0% (0 / 1 tregues të zbatuar);
- Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKKK) – 0% (0 / 1 tregues të zbatuar);
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) – 0% (0 / 1 tregues të zbatuar);
- Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik (KRPP) – 100% (1 / 1 tregues të zbatuar);
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) – 100% (4 / 4 tregues të zbatuar).


Performanca e institucioneve të tjera të pavarura gjatë periudhës prill – shtator 2021 nuk mund të matet pasi që asnjë tregues nën përgjegjësinë e tyre nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë kësaj periudhe.

1. SHYTYLLA I: QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT

1.1. Prioriteti 1.1. Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme

Ky prioritet përmban 77 tregues.

Diagrami 1.1.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.1 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 18.18% e treguesve, 14 tregues, janë zbatuar;
- 23.37% e treguesve, 18 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 6.50% e treguesve, 5 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 10.33% e treguesve, 10 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 38.97% e treguesve, 30 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 12 (15.58%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 1.1.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.1 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e treguesve, 4 tregues, janë zbatuar;
- 66.67% e treguesve, 8 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 1.1. *Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe zbatimi i reformave kryesore në fushën e gjyqësorit dhe atë të punëve të brendshme*

Treguesit **e zbatuar** brenda afateve të planifikuara:

- Miratimi i Strategjisë Sektoriale të Sundimit të Ligjit;
- Emërimi dhe trajnimi i 16 zyrtarëve të Policisë së Kosovës në 8 drejtori rajonale;
- Instalimi i 16 kompjuterëve të specializuar të lidhur me bazën e të dhënave të Inteligjencës për dërgimin e raporteve të informacionit të inteligjencës për çdo Stacion Policor;
- Themelimi dhe funksionalizimi i grupeve punuese të koordinimit për ILP në nivelin qendror dhe lokal.

Treguesit **e zbatuar** para afateve të planifikuara:

- Nënshkrimi i Marrëveshjes për Zyrтарin e Ndërlidhjes me EUROPOL;
- Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimi për vendosjen e një linjeje të sigurt komunikimi me EUROPOL-in;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për shkëmbimin efikas të informacioneve ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit;
- Ristrukturimi i Drejtorisë së PK-së për Inteligjencë dhe Analizë (DIA) në nivelin qendror për të përfshirë tryezat e inteligjencës strategjike dhe rritjen e nivelit të raporteve / informacioneve të inteligjencës të paraqitura nga oficerët e policisë;
- Organizimi i një (1) trajnimi për 10 prokurorë dhe 15 gjyqtarë, për hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit;
- Organizimi i një (1) trajnimi për 15 gjyqtarë dhe 10 prokurorë, për hetimin dhe gjykimin e rasteve të mashtrimit dhe korrupsionin në prokurimin publik;
- Vlerësimi dhe adresimi i ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe efekteve të saj në praktikën aktuale dhe të ardhshme, në veçanti lidhur me grupet e cënueshme dhe qasjen e tyre në drejtësi;
- Funksionalizimi i infrastrukturës së TI-së në të gjitha gjykatat;
- Themelimi dhe funksionalizimi i mekanizmit të referimit për të kthyerit me informacione mbi mbështetjen e ri integritetit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave brenda Policisë Kufitare për identifikimin, regjistrimin dhe referimin e duhur për emigrantët në ardhje.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze**:

- Miratimi i Kodit të Procedurës Penale;
- Miratimi i projektligjit për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publikë;
- Miratimi i projektligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Miratimi i UA për Ekipet e Përbashkëta të Hetimit;
- Hartimi dhe miratimi i UA dhe PSO për trajtimin e informatorëve;
- Miratimi i Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Miratimi i strategjisë për migrim 2020-2025;
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstucional në fushën e migracionit përmes AQM-së.

Nga 12 treguesit e planifikuar për zbatim gjatë periudhës raportuese, 4 prej tyre janë zbatuar brenda afatit, ndërsa 10 tregues të tjerë janë zbatuar para afatit të përcaktuar.

Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026 është miratuar nga Qeveria më 8 gusht 2021. Qëllimi i kësaj strategjie është zbatimi i reformave kyçe në fushën e gjyqësorit, si dhe avancimi i integritetit, llogaridhënies dhe besueshmërisë në sistemin e drejtësisë.

Më tej, emërimi dhe trajnimi i 16 zyrtarëve të Policisë së Kosovës në 8 drejtori rajonale; instalimi i 16 kompjuterëve të specializuar të lidhur me bazën e të dhënave të Inteligjencës për dërgimin e raporteve të informacionit të inteligjencës në çdo stacion policor; krijimi dhe funksionalizimi i grupeve koordinuese të punës për ILP në nivel qendror dhe lokal ndikojnë drejtpërdrejtë në zgjerimin e mëtejshëm të konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjencia në luftën kundër krimit të organizuar.

Sa u përket treguesve të zbatuar para afateve të caktuar, nënshkrimi i marrëveshjes për zyrtarin ndërlidhës me EUROPOL-in dhe nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit për vendosjen e linjës së sigurt të komunikimit me

EUROPOL-in kanë përmirësuar bashkëpunimin e institucioneve të vendit me agjencitë e BE-së dhe shtetet anëtare. Po kështu, nënshkrimi i marrëveshjes për shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit do të ketë ndikim pozitiv në forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar. Për më tepër, ristrukturimi në nivel qendror i Drejtorisë së PK-së për Inteligjencë dhe Analizë (DIA) ashtu që të përfshijë tryezat e rrumbullakëta strategjike të inteligjencës dhe rritjen e nivelit të raporteve/informacioneve të inteligjencës të dorëzuara nga zyrtarët policorë gjithashtu ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mëtejshëm të konceptit të policisë së udhëhequr nga intelijenca në luftën kundër krimit të organizuar.

Sa i përket organizimit të një (1) trajnimit për 10 prokurorë dhe 15 gjyqtarë për hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, me mbështetje të OSBE-së, gjatë periudhës raportuese, është mbajtur një program trajnimit i specializuar për krimin e organizuar dhe korrupsionin (sesioni i tretë). Aty morën pjesë 33 gjyqtarë dhe 13 prokurorë nga Departamentet e Krimeve të Rënda dhe Departamentet e Çështjeve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore dhe ZP-të në të gjitha rajonet, si dhe nga ai i nivelit të Apelit. Gjatë periudhës raportuese është mbajtur edhe një (1) trajnim për 15 gjyqtarë dhe 10 prokurorë mbi hetimin dhe gjykimin e rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit në prokurimin publik. Në këtë trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës (19 gjyqtarë dhe 8 prokurorë) nga Departamentet e Krimeve të Rënda dhe Departamentet e Çështjeve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore dhe ZP-të nga të gjitha rajonet, si dhe nga ai i nivelit të Apelit.

Sa i përket vlerësimit dhe adresimit të ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe efekteve të saj në praktikën aktuale dhe të ardhshme, veçanërisht në lidhje me grupet e cenueshme dhe qasjen e tyre në drejtësi, kjo çështje është diskutuar në mbledhjen e Kuvendit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës të mbajtur më 17 shtator 2021, ku u prezantuan lëndë të ndryshme dhe u vendos që të vazhdohet trajtimi i tyre me prioritet. Gjatë periudhës raportuese është hartuar edhe një analizë për këtë temë. Sa i përket funksionalizimit të infrastrukturës së TI-së në të gjitha gjykatat, KGJK-ja ka pranuar pajisje teknike, duke përfshirë kamera kompjuterike, nga USAID-i në vitin 2020. Po ashtu, gjatë vitit 2021 një numër i madh i gjyqtarëve janë pajisur me kompjuterë dhe kamera dhe KGJK-ja ka përmbushur kërkesat e gjykatave për sigurimin e pajisjeve të TI-së. Rrjedhimisht, gjykatat janë të pajisura mirë për të mbajtur seanca online, për të pasur qasje në ZOOM dhe KGJK-ja do të vazhdojë t'u përgjigjet kërkesave eventuale shtesë nga gjykatat për t'u siguruar atyre pajisjet e nevojshme të TI-së.

Sa i përket themelimit dhe funksionalizimit të mekanizmit referues për të kthyerit me informacione për mbështetjen e riintegrit, mekanizmi i tillë është themeluar dhe është funksional nga momenti i mbërritjes së personave të riadhesuar në pikat kufitare deri në riintegrimin e përhershëm të tyre në Kosovë. Nëpërmjet Qendrës së Pritjes së Personave të Riatdhesuar në pikë kalimet kufitare, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH) ofron pritje dhe ndihmë të organizuar për personat e riadhesuar në momentin e mbërritjes së tyre, pasuar nga informacione, këshillim dhe referim, duke përfshirë përmes fletëpalosjeve informative në gjashtë (6) gjuhë për të drejtat dhe mundësitë për të përfitur nga skemat e riintegrit. Transporti nga PKK-ja në komunën e origjinës së tyre dhe akomodimi urgjent në Qendrën e Akomodimit të të Riatdhesuarve sigurohet gjithashtu sipas nevojës, ndërsa pas mbërritjes në komunën e tyre personat e riadhesuar referohen dhe ndihmohen në aspektin e qasjes në shërbime publike si regjistrimi civil, sigurimi i dokumenteve personale, banimi, arsimit, skemat sociale, shëndetësia, aftësimi profesional, punësimi, ndihma juridike falas, në nivel të barabartë me qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, personat e riadhesuar gjithashtu referohen në dhe mbështeten përmes masave specifike për riintegrim. Në bazë të vlerësimit të nevojave, ata mbështeten materialisht me pako ushqimore, higjienike dhe artikuj të tjerë, si dhe me strehim me qira, asistencë dimërore, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko-sociale, përfshirje të fëmijëve në sistemin arsimor, kurse gjuhësore dhe mësim plotësues, njohje të dokumenteve të arsimit të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës, këshillim për zhvillimin e karrierës, aftësim profesional, punësim dhe vetëpunësim, grante bujqësore; dhe rindërtim ose rinovim i shtëpive dhe mobilieve shtëpiake.

Sa i përket zhvillimit dhe zbatimit të procedurave në kuadër të Policisë Kufitare në aspektin e identifikimit, regjistrimit dhe referimit të duhur të imigrantëve në hyrje, Policia Kufitare kryen identifikimin, regjistrimin dhe referimin e imigrantëve në hyrje në përputhje me dispozitat e Ligjit për Azilin, UA-të përkatëse dhe PSO-

të e PK-së. Këto procedura fillestare të trajtimit nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) nënkuptojnë plotësimin e formularit fillestar të gjetur në Departamentin e Shtetësisë, Azilit dhe Migrimin (DSHAM) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ndërsa më pas bëhet fotografimi i tyre dhe u merren shenjat e gishtave në mënyrë manuale dhe vendosen në sistemin elektronik, ndjekur nga përgatitja e kopjes fizike të dosjes dhe një kopje dorëzohet pranë DSHAM-së si autoritet vendimmarrës për shqyrtim. DMH mban një kopje si dëshmi, ndërsa të dhënat e futura në sistemin e saj elektronik dërgohen automatikisht në DSHAM. Sapo të përfundohen këto procedura në lidhje me aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare ose azilkërkuesit, ose nëse ai/ajo është edhe refugjat, akomodohen në Qendrën e Azilit në Magure, ku qendra përkujdeset për ta.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur vonesa të konsiderueshme në zbatimin e nëntë (9) treguesve.

Sa i përket *miratimit të Kodit të Procedurës Penale*, i njëjti është miratuar nga Qeveria më datën 25 gusht 2021 dhe i është dorëzuar Kuvendit për procedim të mëtutjeshëm. Si rezultat i vëllimit të konsiderueshëm të dokumentit dhe paraqitjes së komenteve nga palë të ndryshme të interesit, procedurat për miratim në Kuvend kanë marrë më shumë kohë se sa ishte parashikuar.

Sa i përket *miratimit të projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve publikë*, i njëjti nuk ka mundur të miratohet nga ana e Qeverisë gjatë periudhës raportuese si pasojë e numrit të madh të komenteve dhe rekomandimeve të marra në fazën e grupeve punuese si dhe për shkak të opinionëve të ndryshme në grupin punues mbi disa dispozita të propozuara.

Vonesa të konsiderueshme ka edhe në *miratimin e projektligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit*. I njëjti nuk mundi të miratohet nga Qeveria gjatë periudhës raportuese për shkak të numrit të madh të komenteve dhe rekomandimeve të marra në fazën e grupit punues.

Sa i përket *miratimit të UA për Ekipet e Përbashkëta Hetimore*, ka pasur vonesa të konsiderueshme gjatë periudhës raportuese për shkak të paqartësive lidhur me bazën ligjore. Pas analizës mbi këtë, është konstatuar se nuk ka bazë ligjore për miratimin e këtij UA dhe është vendosur që të mos vazhdohet me këtë. Policia e Kosovës gjatë periudhës raportuese ka punuar në PSO të re për Ekipet e Përbashkëta Hetimore.

Sa i përket *miratimit të UA dhe PSO për trajtimin e informatorëve*, gjatë periudhës raportuese u krijua grupi i ngarkuar me rishikimin e UA dhe PSO. Pas rishikimit të UA dhe PSO, grupi ka vlerësuar se UA nuk ka nevojë të ndryshohet, pasi ndryshimet e nevojshme në PSO nuk kërkojnë që UA të ndryshohet. Këto ndryshime, të bëra gjatë periudhës raportuese, janë përfshirë në PSO, i cili është dorëzuar për miratim. Prandaj, konsiderohet se ndryshimi i PSO është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin për të cilin është propozuar ky tregues.

Nuk ka pasur progres gjatë periudhës raportuese në aspektin e *miratimit të Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar*.

Gjithashtu ka pasur vonesa të konsiderueshme në *miratimin e strategjisë së migrimit 2020-2025*. Strategjia është hartuar me kohë, por ka pasur kërkesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për të hequr objektivin e tretë, me fokus diasporën. Kjo është arsyeja pse draft-strategjia dhe plani i veprimit kërkoi ri hartim të pjesshëm.

Sa i përket *forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në fushën e migrimit përmes Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM)*, plani fillestar ishte hartimi i një rregulloreje për funksionimin e AQM-së, gjë e cila do të qartësonte rolin dhe përgjegjësitë e saj. Ndonëse MPB-ja gjatë periudhës raportuese e ka përgatitur projekt-rregulloren, Zyra Ligjore e ZKM-së ka vlerësuar se nuk ka bazë ligjore për rregullore të tillë pasi asnjë ligj nuk e parashihet këtë dhe rrjedhimisht nuk mund të hartohet e njëjta. Për këtë arsye hartimi i kësaj rregulloreje është pezulluar për momentin deri sa të gjendet zgjidhje tjetër. Zgjidhje e mundshme do të ishte miratimi i një vendimi të Qeverisë për ndryshimin e vendimit ekzistues, për të përcaktuar më qartë përgjegjësitë e AQM-së. MPB-ja po ashtu planifikon të bëjë rishikim funksional të AQM-së në fillim të vitit 2022, me qëllim krijimin e bazës ligjore për miratimin e vendimit të tillë të Qeverisë dhe të rregullave të

funksionimit të brendshëm të AQM-së. Rishikimi i tillë do të shqyrtonte gjithashtu nivelet e përfaqësimit dhe kapacitetin e nevojshëm për funksionimin efektiv dhe efikas të këtij mekanizmi. Ndryshe, deri më sot, AQM-ja ka qenë funksionale dhe ka pasur bashkëpunim ndërinstitucional në hartimin e një sërë dokumentesh të politikave për tema të ndryshme në fushën e migrimit, hartimit të Strategjisë së Migrimit 2021-2025 dhe Planit të Veprimit dhe Profilit të Migrimit 2020, inicimin e procesit të rishikimit të sistemeve të migrimit të brendshëm, përditësimi i planit të komunikimit të AQM-së, si dhe në organizimin e trajnimeve dhe seminareve të shumta të ndjekura nga anëtarët e AQM-së.

Sa u përket *treguesve të tjerë*, gjatë periudhës raportuese ka pasur progres drejt *miratimit të koncept dokumentit për krijimin e fondit të konfiskimit*. Qëllimi i miratimit të këtij koncept dokumenti është krijimi i bazës ligjore për krijimin e fondit apo programit konfiskues, si dhe për destinimin e të ardhurave nga shitja e aseteve të konfiskuara dhe përdorimin e këtyre të ardhurave të cilat duhet të administrohen nga ana e Agjencisë së MD-së për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK). Ideja fillestare ishte krijimi i mekanizmit (i cili mund të ishte Komiteti Drejtues me anëtarësi të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të zbatimit të ligjit) i ngarkuar për t'i rekomanduar AAPSK-së atë se çfarë të bënte me asetet. Për implementimin e kësaj politike duhet vendosur procedura dhe politika të detajuara. Kjo ide e fondit të konfiskimit është kundërshtuar nga MFPT dhe kjo është arsyeja pse koncept dokumenti ende nuk është finalizuar.

Lidhur me *Vlerësimin e Kërcënimit nga Krimet të Rënda dhe Krimet e Organizuara (SOCTA)*, i njëjti, sipas praktikës, hartohet çdo tri vjet. Policia e Kosovës e ka hartuar atë në vitin 2019, duke përfshirë tri vitet e mëparshme. Raporti i radhës, që mbulon periudhën 2019-2021, do të hartohet në vitin 2022. Kjo do të thotë se afati kohor i zbatimit të këtij treguesi shtyhet për vitin e ardhshëm.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 18 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 5 tregues përballen me vonesa të vogla;
- 30 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

1.2. Prioriteti 1.2. Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, duke u bazuar në legjislacionin e ri kornizë në fuqi

Ky prioritet përmban 25 tregues.

Diagrami 1.2.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.2 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 12% e treguesve, 3 tregues, janë zbatuar;
- 36% e treguesve, 9 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 4% e treguesve, 1 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 12% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 36% e treguesve, 9 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 4 (16%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 1.2.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.2 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 75% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 1.2. *Forcimi i mëtejshëm i performancës në zbatimin e reformës së administratës publike, bazuar në kornizën e re ligjore në fuqi*

Treguesit **e zbatuar:**

- Zhvillimi i moduleve në SIMBNj për të gjitha procedurat e rekrutimit, transferimit dhe avancimit;
- Zhvilli i Bankës së pyetjeve për Nivelin e Lartë Drejtues (NLD);
- Shfuqizimi i të paktën 8% të lejeve dhe licencave për operatorët ekonomikë.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze:**

- Hartimi i udhëzuesit për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive për zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
- Hartimi i udhëzuesit për zhvillimin e intervistës;
- Hartimi i memorandumit shpjegues rreth projektligjit për valën e dytë të racionalizimit të agjencive.

Nga 4 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 1 prej tyre është zbatuar brenda afatit. Ky tregues është zhvillimi i Listës së Pyetjeve për Nivelin e Lartë Drejtues (NLD).

Gjithashtu, dy tregues janë zbatuar para afatit të caktuar. Njëri prej tyre është zhvillimi i moduleve në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) për të gjitha procedurat e rekrutimit, transferimit dhe promovimit. Të gjitha modulet përkatëse janë zhvilluar dhe janë funksionale. SIMBNJ është i qasshëm përmes ueb-faqes (<https://konkursi.rks-gov.net/>), ku janë publikuar të gjitha pozitat. Ajo u mundëson aplikuesve të interesuar të aplikojnë për pozita, të dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara, të shohin rezultatet e proceseve të përzgjedhjes dhe të paraqesin ankesa lidhur me procedurat e përzgjedhjes. Treguesi tjetër i zbatuar para afatit të caktuar është heqja e të paktën 8% e lejeve dhe licencave për operatorët ekonomikë.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur vonesa të konsiderueshme në zbatimin e 3 treguesve.

Lidhur me hartimin e udhëzuesit për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive për zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (LOFASHAP), ka pasur vonesa për shkak se në bazë të Rregullores së re (QRK) Nr. 03/2020 për Performancën e Agjencive nuk ishte e qartë se a ishte ZKM-ja apo MPB-ja përgjegjëse për hartimin e këtij udhëzimi.

Së dyti, hartimi i udhëzuesit për realizimin e intervistave ishte planifikuar të zbatohet deri në fund të vitit.

Së fundi, lidhur me hartimin e memorandumit shpjegues për projektligjin për valën e dytë të racionalizimit të agjencive, ka pasur vonesa sepse është dashur më shumë kohë për të konsultuar institucionet e prekura lidhur me projektligjin. Memorandumi dhe projektligji planifikohen të miratohen deri në fund të vitit.

Sa u përket *treguesve të tjerë*, gjatë periudhës raportuese është shënuar progres drejt ndryshimit të gjashtë (6) rregulloreve për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe miratimin e projektligjit për valën e parë të racionalizimit të agjencive dhe miratimin e projektligjit për valën e dytë të racionalizimit të agjencive.

Nga gjashtë (6) rregulloret e ndryshuara për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, njëra prej tyre, për përfituesit nga skema e bursave, u propozua të pezullohej, ndërsa pesë (5) të tjerat ishin në përgatitje dhe po kërkohet të miratohen deri në fund të vitit. Megjithatë, vonesat e mundshme në miratimin e Ligjit të rishikuar për Zyrtarët Publikë mund të shkaktojnë vonesa në miratimin e këtyre rregulloreve.

Sa i përket miratimit të projektligjit për valën e parë të racionalizimit të agjencive dhe miratimin e projektligjit për valën e dytë të racionalizimit të agjencive, të dy projektligjet janë finalizuar gjatë periudhës raportuese. Ky i fundit ishte duke u përgatitur për konsultime publike dhe që të dyja pritet të miratohen nga Qeveria deri në fund të vitit dhe të miratohen nga Kuvendi në fillim të vitit 2022.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 9 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 1 tregues përballet me vonesa të vogla;
- 9 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

1.3. Prioriteti 1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore

Ky prioritet përmban 41 tregues.

Diagrami 1.3.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.3 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 2.44% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 65.86% e treguesve, 27 tregues është në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 4.88% e treguesve, 2 tregues është në zbatim e sipër, me vonesa të vogla;
- 7.31% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 19.51% e treguesve, 8 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 3 (7.31%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 1.3.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.3 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 66.67% e treguesve, 2 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 1.3. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore

Treguesit **e zbatuar:**

- *Publikimi i hulumtimit mbi perceptimin e qytetarëve për diversitetin dhe barazinë në vend.*

Treguesit që përballen **me vonesa serioze:**

- *Rishikimi i projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media;*
- *Miratimi i Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.*

Nga 3 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 1 prej tyre është zbatuar brenda afatit. Ky tregues është *publikimi i hulumtimit mbi perceptimin e qytetarëve për diversitetin dhe barazinë në vend*. Raporti u publikua dhe u prezantua në një aktivitet publik të mbajtur më 15 qershor 2021.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur vonesa të konsiderueshme në zbatimin e dy (2) treguesve: *rishikimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe miratimi i Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut*.

Lidhur me *rishikimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave*, drafti i zhvilluar gjatë periudhës raportuese është në përputhje me acquis përkatëse të BE-së, dhe projektligji kërkohet të miratohet në Qeveri brenda këtij viti dhe t'i dërgohet Kuvendit për miratim përfundimtar.

Sa i përket *miratimit të Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut*, drafti ishte duke u finalizuar në fund të periudhës raportuese dhe ishte kërkuar që të miratohej nga Qeveria në tetor.

Lidhur me *treguesit e tjerë*, ka pasur progres gjatë periudhës raportuese drejt *hartimit të koncept dokumentit për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve*. Gjatë periudhës raportuese është krijuar një grup pune për hartimin e këtij koncept dokumenti.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 27 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 2 tregues përballen me vonesa të vogla;
- 1 tregues përballen me vonesa serioze: dhe
- 8 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

1.4. Prioriteti 1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore

Ky prioritet përmban 10 tregues.

Diagrami 1.4.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.4 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e treguesve, 4 tregues, janë zbatuar;
- 10% e treguesve, 1 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 20% e treguesve, 2 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 20% e treguesve, 2 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 10% e treguesve, 1 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 5 (50%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 1.4.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 1.4 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 80% e treguesve, 4 tregues, janë zbatuar;
- 20% e treguesve, 1 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 1.4. Forcimi i mëtejshëm i proceseve zgjedhore

Treguesit **e zbatuar:**

- Mbatja e trajnimeve për parandalimin e mashtrimeve zgjedhore;
- Organizimi i aktiviteteve për informim të votuesve rreth shkeljeve zgjedhore;
- Përditësimi i manualeve të trajnimit të stafit zgjedhor;
- Pastrimi i listës së votuesve duke rritur saktësinë e listës së votuesve përmes përditësimit të listës së pensionistëve nga viti 2000 deri më tani.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze:**

- Miratimi i Projektligji për financimin e subjekteve politike;
- Themelimi i Komitetit ad hoc dhe Grupit Këshillëdhënës.

Nga 5 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 4 prej tyre janë zbatuar brenda afatit.

Gjatë periudhës raportuese KQZ ka kryer *përditësimin e rregullt të manualeve të trajnimit të stafit zgjedhor* për ata që punojnë me këshillat e qendrave të votimit përpara zgjedhjeve lokale të këtij viti. Sa i përket *mbajtjes së trajnimeve për parandalimin e mashtrimit zgjedhor*, mbi 20,000 anëtarë të këshillave të qendrave të votimit janë trajnuar për këtë temë gjatë periudhës raportuese. Për *aktivitetet e informimit të votuesve mbi shkeljet zgjedhore*, informacionet e tilla përfshihen gjithmonë në të gjitha produktet (videoklipe, postera, etj.) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat transmetohen përmes mediave.

E fundit, gjatë periudhës raportuese është bërë edhe *pastrimi i listës së votuesve duke rritur saktësinë e listës zgjedhore duke përditësuar listën e pensionistëve nga viti 2000 e deri më tani*. Lista e votuesve u pastrua duke hequr prej saj personat e dyshuar si të vdekur, pra të çaktivizuar nga Departamenti i Pensioneve, si dhe ata që nuk kanë aplikuar për dokumentet e Republikës së Kosovës pas skadimit të atyre të UNMIK-ut (të cilat nuk janë të vlefshme prej më shumë se 10 vitesh). Kjo ndikon në përmbushjen e rekomandimeve të misionit të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve në lidhje me regjistrimin e qytetarëve, prioritet i cili synohet të përmbushet plotësisht në mesin e vitit 2023 me ndërlidhjen e suksesshme të sistemit të gjendjes civile dhe sistemit të adresave, si dhe me konsolidimin e kornizës ligjore në këtë fushë.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur vonesa të konsiderueshme në zbatimin e 2 treguesve: *miratimi i projektligjit për financimin e subjekteve politike dhe krijimi i komisionit ad hoc dhe grupit këshillëdhënës për reformën zgjedhore*.

Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit ka hartuar gjatë periudhës raportuese *projektligjin për financimin e subjekteve politike* dhe drafti ishte në konsultim të brendshëm gjatë periudhës raportuese, me qëllimin për të vazhduar më pas me procedurat e mëtejshme.

Ka pasur përpjekje të shumta në nivelin e shërbimit civil për të përsheptuar krijimin e komitetit *ad hoc* dhe grupit këshillimor, por ato ishin përpjekje të pasuksesshme. Rekomandohet që kjo çështje të ngrihet në nivel politik dhe ZKM-ja mirëpret që të ndihmohet drejtpërdrejt nga kabineti i kryetarit të Kuvendit përmes kabinetit të zëvendëskryeministrit.

Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:


- 3 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 1 tregues përballet me vonesa të vogla;
- 1 tregues ishte planifikuar të zbatohet në të ardhmen.

2. SHTYLLA II: KONKURRUESHMËRIA, KLIMA E INVESTIMEVE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

2.1. Prioriteti 2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të, dhe promovimi i investimeve të huaja direkte

Ky prioritet përmban 34 tregues.

Diagrami 2.1.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.1 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 14.71% e treguesve, 5 tregues, janë zbatuar;
- 47.06% e treguesve, 16 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 8.82% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 29.41% e treguesve, 10 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 1 (2.94%) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.1.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.1 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 1 tregues, janë zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 2.1. Përmirësimi i tregut të brendshëm dhe i kapaciteteve për të mbështetur investimet, sektorin privat dhe NMVM-të, dhe promovimi i investimeve të huaja direkte

Treguesi **i zbatuar:**

- Miratimi i UA për përfaqësitë e huaja.

Asnjë tregues nuk përballen **me vonesa serioze.**

Treguesi i planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese është *zbatuar brenda afatit*. Ky tregues është miratimi i UA për përfaqësitë e huaja. Qeveria ka miratuar UA nr. 05/2021 për regjistrimin e zyrave së përfaqësisë të shoqërive të huaja tregtare më 8 qershor 2021 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=43087>). Ai përcakton kërkesat, kushtet dhe procedurat për regjistrimin fillestar dhe ndryshimin e mëpasshëm të të dhënave për zyrat e përfaqësisë të

shoqërive të huaja tregtare. Miratimi i këtij UA kontribuon në zbatimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe në përmirësimin e mjedisit të biznesit duke rregulluar kushtet dhe procedurat e regjistrimit të zyrave të përfaqësisë të shoqërive të huaja tregtare.

Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur tregues me vonesa të konsiderueshme në kuadër të këtij prioriteti.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 16 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 3 tregues përballen me vonesa të vogla; dhe
- 14 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

2.2. Prioriteti 2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të efijencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme

Ky prioritet përmban 24 tregues.

Diagrami 2.2.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.2 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 8.33% e treguesve, 2 tregues, janë zbatuar;
- 20.83% e treguesve, 5 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 16.67% e treguesve, 4 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 16.67% e treguesve, 4 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 37.5% e treguesve, 9 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 4 (16.66%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.2.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.2 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e treguesve, 2 tregues, janë zbatuar;
- 50% e treguesve, 2 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 2.2. Angazhimi drejt përmbushjes së caqeve të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme

Treguesit **e zbatuar:**

- Miratimi i UA për kriteret e eficiencës së energjisë për rregullimin e rrjetit të energjisë dhe për tarifën e rrjetit të energjisë elektrike;
- Miratimi i UA për kërkesat e eficiencës së energjisë për operatorët e sistemit të bartjes dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze:**

- Miratimi i UA për kornizën e përgjithshme të raportimit për eficiencën e energjisë;
- Miratimi i UA për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MZHE) nr. 03/2019 mbi përmbajtjen e energjisë së karburanteve të zgjedhura për përdorim përfundimtar;
- Miratimi i konceptit dokumentit për BRE.

Nga 5 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 2 prej tyre janë zbatuar brenda afatit.

UA (ME) nr. 01/2021 për Kërkesat e Eficiencës së Energjisë për Operatorët e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes është miratuar nga Ministri i Ekonomisë më 15 korrik 2021 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=43983>). Ky UA zbaton Ligjin për Eficiencë të Energjisë dhe është një hap përpara në përafrimin me *acquis* të BE-së për eficiencë të energjisë. Miratimi i tij është hap progresiv drejt arritjes së objektivave të kursimit të energjisë sipas objektivave të vendosura nga Komuniteti i Energjisë. Ai gjithashtu do të ndikojë në uljen e humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

UA (ME) nr. 02/2021 për Kriteret e Eficiencës së Energjisë për Rregullimin e Rrjetit të Energjisë dhe për Tarifën e Rrjetit të Energjisë Elektrike është miratuar nga Ministri i Ekonomisë më 15 korrik 2021 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43989>). Ai zbaton Ligjin për Eficiencë të Energjisë dhe është një hap përpara në përafrimin me *acquis* të BE-së për eficiencë të energjisë. Miratimi i tij është gjithashtu hap progresiv drejt arritjes së objektivave të kursimit të energjisë sipas objektivave të vendosura nga komuniteti i energjisë. Kjo gjithashtu redukton koston e shpërndarjes ose investimeve në rrjet dhe siguron funksionim më optimal të rrjetit.

Ka pasur *vonesa të konsiderueshme* gjatë periudhës raportuese në zbatimin e 3 treguesve: *miratimin e UA për kornizën e përgjithshme raportuese për eficiencë të energjisë; miratimin e UA për ndryshimin e UA (MZHE) nr. 03/2019 për përmbajtjen e energjisë së lëndëve djegëse të përcaktuara për përdorim fundor; dhe miratimin e Konceptit Dokumentit për BRE*. Të dy UA-të kanë qenë në proces të hartimit gjatë periudhës raportuese dhe janë kërkuar të miratohen deri në fund të vitit, ndërkohë që nuk ka pasur progres në hartimin e konceptit dokumentit për BRE.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 5 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 4 tregues janë me vonesa të vogla;
- 9 tregues janë planifikuar për të ardhmen.

2.3. Prioriteti 2.3. Trajtimi i sfidave prioritare mjedisore: Reflektimi i objektivave të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor në zbatimin e politikave në fushën e mjedisit

Ky prioritet ka 27 tregues.

Diagrami 2.3.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.3 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 55.55% e treguesve, 15 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 14.82% e treguesve, 4 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 11.11% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 18.52% e treguesve, 5 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 3 (11.11%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.3.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.3.– treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 2 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Asnjë tregues nuk është **zbatuar**.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze**:

- Miratimi i projektligjit për mbeturinat;
- Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës;
- Fillimi i zbatimit të projekteve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme: objektin për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme, dekomisionimi i TC Kosova A.

Nga 3 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, të gjithë u përballën me vonesa të konsiderueshme. Miratimi i projektligjit për mbeturinat është përballur me vonesa për shkak se pandemia ka ndërprerë punën e grupit punues. Ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës është përballur me vonesa sepse grupi punues mund të takohej vetëm në mënyrë virtuale për shkak të pandemisë, dhe takimet nuk ishin aq efektive sa duhej. Konsultimi publik për këtë projektligj ka përfunduar më 17 gusht 2021 dhe më pas

janë adresuar komentet dhe është publikuar raporti konsultativ. Mirëpo, projektligji në ndërkohë ka pësuar ndryshime të mëdha dhe për këtë MMPHI ka vendosur të mos vazhdojë më tutje, por fillimisht të hartojë një Koncept Dokument për zonën e natyrës, në vitin 2022, dhe më pas të hartojë një ligj të ri për ruajtjen e natyrës në vitin 2023.

Ka pasur vonesa të konsiderueshme në fillimin e zbatimit të projekteve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme: objekti për deponim të përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme, dekomisionimi i Kosovës sepse ende nuk është përcaktuar lokacioni për ndërtimin e objektit për deponimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme. Edhe pse zyrtarët e MMPHI-së që janë përgjegjës për këtë projekt kanë mbajtur disa takime me kryetarët e komunave të lokacioneve të propozuara, ende nuk është arritur marrëveshje për lokacionin e një objekti të tillë. MMPHI vazhdon konsultimin me Komunitet për këtë gjë deri në arritjen e marrëveshjes për lokacionin. Në të njëjtën kohë, ka diskutime ndërmjet KEK-ut dhe Zyrës së BE-së në Kosovë për përdorimin e mundshëm të një hangari brenda objektit të TC Kosova A si depo e përkohshme e mbeturinave të rrezikshme.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 15 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 4 tregues përballen me vonesa të vogla;
- 5 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

2.4. Prioriteti 2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i zbatimit të reformave për menaxhimin e financave publike dhe të prokurimit publik

Ky prioritet përmban 15 tregues.

Diagrami 2.4.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.4. – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 6.66% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 46.67% e treguesve, 7 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 20% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 26.67% e treguesve, 4 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 1 (6.66% e tyre) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.4.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.4 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 1 tregues, janë zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i zbatimit të reformave për menaxhimin e financave publike dhe të prokurimit publik

Treguesit **e zbatuar:**

- Publikimi i të dhënave të prokurimit dhe kontratave të nënshkruara në formatin e të dhënave të hapura për 100% të aktiviteteve të prokurimit të kryera përmes sistemit të prokurimit elektronik.

Asnjë tregues nuk përballen **me vonesa serioze.**

Treguesi i planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese është zbatuar brenda afatit. Ky tregues është publikimi i të dhënave të prokurimit dhe kontratave të nënshkruara në formatin e të dhënave të hapura për 100% të aktiviteteve të prokurimit të kryera përmes sistemit të prokurimit elektronik. Të dhënat e prokurimit dhe kontratat e nënshkruara në formatin e të dhënave të hapura për 100% të aktiviteteve të prokurimit janë duke u publikuar përmes sistemit të prokurimit elektronik, përkatësisht aplikacionit softuerik të zhvilluar nga KRPP (<https://ocdskrpp.rks-gov.net>). Deri më tani janë publikuar 31,500 të dhëna për njoftimet e kontratave apo aktivitetet e prokurimit dhe 25,000 kontrata të nënshkruara, që mbulojnë periudhën kohore nga 1 janari 2017 e tutje. Të dhënat publikohen në kohë reale. Hapja e të dhënave të prokurimit publik ka rritur transparencën dhe ka lehtësuar shumë punën e organeve të sundimit të ligjit si Zyra Kombëtare e Auditimit, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe palë të tjera të interesuara që mund të kenë qasje në të gjitha dokumentet nga zyrat e tyre.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 7 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 3 tregues përballen me vonesa të vogla;
- 4 tregues janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

2.5. Prioriteti 2.5. Forcimi i mëtejshëm i institucioneve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore:

Ky prioritet përmban 13 tregues, asnjëri prej të cilëve nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.5.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.5 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 7.70% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 38.46% e treguesve, 5 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 7.70% e treguesve, 1 tregues është në zbatim e sipër, me vonesa të vogla;
- 30.76% e treguesve, 4 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 15.38% e treguesve, 2 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

2.1. Prioriteti 2.6. Vazhdimi i përpjekjeve për të trajtuar ekonominë joformale

Ky prioritet përmban 8 tregues, asnjëri prej të cilëve nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 2.6.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 2.6 – të gjithë treguesit



Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 8 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

3. SHYLLA III: PUNËSIMI, ARSIMI DHE SHËNDETËSIA

3.1. Prioriteti 3.1. Zbatimi i masave me objektiva të qartë për rimëkëmbje sociale dhe ekonomike pas COVID-19

Ky prioritet përmban 9 tregues, asnjëri prej të cilëve nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 3.1.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.1 – të gjithë treguesit



Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 66.67% e treguesve, 6 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 33.33% e treguesve, 3 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

3.2. Prioriteti 3.2. Rritja e punësimit dhe mirëqenies së përgjithshme

Ky prioritet përmban 8 tregues.

Diagrami 3.2.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.2 – të gjithë treguesit



Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 62.5% e treguesve, 5 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 12.5% e treguesve, 1 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 25% e treguesve, 2 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 1 (12.5%) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 3.2.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.2 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 1 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 3.2. Rritja e punësimit dhe mirëqenies së përgjithshme

Asnjë tregues nuk është **zbatuar**.

Tregues që përballen **me vonesa serioze:**

- Krijimi i një grupi ekspertësh dhe një Grup të Nivelit të Lartë për Skemën e garantimit për të rinj.

Treguesi i planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese është *përballur me vonesa të konsiderueshme*. Gjatë periudhës raportuese nuk ishte e mundur të krijohet një grup i ekspertëve për Skemën e Garancisë për të Rinj. Ky tregues tashmë është plotësuar, pasi janë krijuar të dy grupet që lidhen me Skemën e Garancisë për të Rinj: Qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e Grupit të Nivelit të Lartë (të përbërë nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve; Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal), dhe Grupit të Nivelit të Ekspertëve (me ç'rast është emëruar koordinatori kombëtar).


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 5 tregues janë ë zbatim e sipër, pa vonesa;
- 2 tregues janë planifikuar për të ardhmen.

3.3. Prioriteti 3.3. Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë

Ky prioritet përmban 11 tregues.

Diagrami 3.3.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.3 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 9.09% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 72.72% e treguesve, 8 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 9.09% e treguesve, 1 tregues është në zbatim e sipër, me vonesa të vogla;

- 9.10% e treguesve, 1 tregues, përballet me vonesa serioze.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 1 (9.09%) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 3.3.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.3 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 1 tregues, janë zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballet me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 3.3. *Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë në punë*
 Treguesit **e zbatuar:**

- *Hartimi dhe publikimi i 35 listave kontrolluese për inspektorët e punës dhe punëdhënësit.*

Asnjë tregues nuk përballet **me vonesa serioze.**

Treguesi i planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese është *zbatuar brenda afatit*. Konkretisht, 33 lista kontrolluese për inspektorët e punës dhe punëdhënësit për shëndetin dhe sigurinë në punë (SSHP) u hartuan nga Inspektorati i Punës (IP) dhe u publikuan në faqen e tij zyrtare të internetit (https://ip.rks.gov.net/?page_id=3735#). Ato mbulojnë aspektet e mëposhtme: Sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të SSHP (1 listë kontrolluese); Faktorët e rrezikut fizik (8 lista kontrolluese); Pluhuri dhe agjentët kimikë (5 lista kontrolluese); Faktorët e rrezikut ergonomik (5 lista kontrolluese); Faktorët e rrezikut psikosocial (1 listë kontrolluese); Agjentët biologjikë (2 lista kontrolluese); Rreziqet e lidhura me aksidentet në punë (8 lista kontrolluese); dhe Masat specifike parandaluese (3 lista kontrolluese).

Këto lista kontrolluese janë të dobishme për shumicën e vizitave të inspektimeve të përgjithshme dhe për inspektimet specifike. Ato janë mjete kyçe që inspektorët e punës të mbledhin informacione në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Këto të dhëna më pas përdoren për të inkurajuar punëdhënësit ose për t'u kërkuar atyre të përmirësojnë vendet e punës në përputhje me ligjin. Kjo do të ndihmojë gjithashtu menaxhmentin e IP që të marrë vendime dhe të kryejë veprimet vijuese. Secila listë kontrolluese është gjithashtu e përshtatur për nevojat e punëdhënësvë, në mënyrë që ata të mund të bëjnë vetëvlerësime të pajtueshmërisë me aktet ligjore, të cilat gjithashtu publikohen veçmas për punëdhënësit.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 8 tregues janë ë zbatim e sipër, pa vonesa;
- 1 tregues përballet me vonesa të vogla;
- 1 tregues përballet me vonesa serioze.

3.4. Prioriteti 3.4. Përmirësimi i sistemit arsimor të Kosovës

Ky prioritet përmban 28 tregues.

Diagrami 3.4.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.4 – të gjithë treguesit




Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 4.17% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 58.33% e treguesve, 14 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 16.66% e treguesve, 7 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 12.51% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze;
- 8.33% e treguesve, 2 tregues, janë planifikuar të zbatohen në të ardhmen.

Nga të gjithë treguesit e këtij prioriteti, 3 (12.5%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 3.4.2. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.4 – treguesit e planifikuar për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të treguesve të planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë se të gjithë treguesit, 3 tregues, përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

Prioriteti 3.4. Përmirësimi i sistemit arsimor të Kosovës

Treguesit **e zbatuar:**

- UA për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues para-universitar, duke përfshirë aspektet gjinore, i miratuar.

Treguesit që përballen **me vonesa serioze:**

- Miratimi i projektligjit për Agjencinë e Akreditimit;
- Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MASHTI;
- Standardet për monitorim të miratuara.

Nga 4 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 1 prej tyre është zbatuar brenda afatit. Ky tregues është miratimi i UA për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe

të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, duke përfshirë aspektet gjinore. Miratimi i këtij UA, nga Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, është një hap përpara në trajtimin e sfidës për rritjen e transparencës në lidhje me rekrutimin e stafit në institucionet arsimore në të gjitha nivelet.

Tre tregues të këtij prioriteti u përballën me vonesa të konsiderueshme gjatë periudhës raportuese. Miratimi i projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim u vonua për shkak të vonesave në krijimin e grupit punues dhe, deri në fund të periudhës raportuese, procesi i hartimit ishte ende në fazën e grupit punues. Në mënyrë të ngjashme, miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MASHT është vonuar për shkak të vonesave në krijimin e grupit punues. Një grup i tillë punues nuk është krijuar as gjatë periudhës raportuese, gjegjësisht nuk ka pasur as edhe një draft fillestar gjatë kësaj periudhe. Së fundi, miratimi i standardeve të monitorimit u vonua për shkak të dallimeve të theksuara ndërmjet anëtarëve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) për to. Prandaj, deri në fund të periudhës raportuese, hartimi i udhëzimeve të monitorimit ishte në fazën fillestare dhe synohet që ato të miratohen në tremujorin e parë të vitit 2022.


Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 14 tregues në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 5 tregues janë duke u zbatuar me vonesa të vogla;
- 2 tregues janë planifikuar që të zbatohen në të ardhmen.

3.5. Prioriteti 3.5. Forcimi i funksioneve kyçe të sistemit shëndetësor

Ky prioritet përmban 11 tregues, asnjëri prej të cilëve nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.

Diagrami 3.5.1. Zbatimi i PV ERA II gjatë periudhës korrik – shtator 2021: Prioriteti 3.5 – të gjithë treguesit



Sa i përket ecurisë së zbatimit të këtij prioriteti deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 9.09% e treguesve, 1 tregues, janë zbatuar;
- 18.19% e treguesve, 2 tregues, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 45.45% e treguesve, 5 tregues, përballen me vonesa të vogla;
- 27.27% e treguesve, 3 tregues, përballen me vonesa serioze;

Siç tregojnë gjetjet e raportit, treguesit e këtij prioriteti të cilët janë zbatuar dhe ata që përballen me vonesa serioze janë të listuar në kutinë në vijim.

<p>Prioriteti 3.5. Forcimi i funksioneve kyçe të sistemit shëndetësor</p> <p>Treguesi zbatuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i zbatimit të strategjisë 2017-2021. <p>Treguesit që përballen me vonesa serioze:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i projektligjit për sigurime shëndetësore; • Miratimi i strategjisë sektoriale të shëndetësisë 2022-2032; • Miratimi i listës dhe çmimoreve të shërbimeve shëndetësore.

Nga 4 treguesit e planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese, 1 prej tyre është zbatuar brenda afatit.

Për të identifikuar veprimet prioritare për hartimin e një strategjie të re sektoriale të shëndetësisë dhe për forcimin e sistemit shëndetësor ka qenë i nevojshëm vlerësimi i zbatimit të *Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë për vitet 2017-2021*.

3 tregues të këtij prioriteti u përballën me vonesa të konsiderueshme gjatë periudhës raportuese.

Sa i përket miratimit të projektligjit për sigurimet shëndetësore, të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), ka pasur vonesa të konsiderueshme për shkak të ngarkesës së menaxhimit të pandemisë që përfshin stafin e ministrisë. Miratimi i *Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2022-2032* dhe miratimi i listës dhe çmimoreve së shërbimeve shëndetësore u vonuan për të njëjtën arsye dhe u bartën në vitin 2022.

Më tej, gjendja për treguesit e tjerë të këtij prioriteti është si në vijim:

- 2 tregues janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 5 tregues përballen me vonesa të vogla.